

VENDIM
Nr. 32, datë 23.4.2024

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Elsa Toska	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahimimi	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, më datë 23.4.2024, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 5 (R) 2023 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: REZART MYSLYMI, përfaqësuar nga avokat Zenun Hajdarmataj, me prokurë të posaçme.

SUBJEKT I INTERESUAR: PROKURORIA E PËRGJITHSHME, përfaqësuar nga prokurori Isa Jata, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-731(136), datë 25.4.2023, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 31, 33, 42, 131, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*), ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Sonila Bejtja, mori në shqyrtim parashtimet me shkrim të kërkuarit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, i cili ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Rezart Myslymi është ndjekur penalisht nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier, pasi nga kontrolli i ushtruar më datë 11.12.2013, në lokalitë të marrë me qira prej tij, shërbimet e Policisë Gjyqësore të Drejtorisë së Policisë së qarkut Fier kanë gjetur bimë narkotike dhe material të ngjashëm me bimën narkotike *cannabis sativa*.

2. Më datë 18.7.2014, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier ka përcjellë për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier procedimin penal nr. 789/2013 në ngarkim të kërkuarit për kryerjen e veprës penale “Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike”, të parashikuar nga neni 283, paragrafi i parë, i Kodit Penal (KP).

3. Me vendimin nr. 472, datë 13.6.2016, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ka vendosur deklarim fajtor të kërkuarit për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike”, të parashikuar nga neni 283, paragrafi i parë, i KP-së dhe dënimin e tij me 5 vjet burgim. Sipas gjykatës, nga administrimi

i provave materiale, akteve të ekspertimit kimik, mjekoligjor dhe toksikologjik është provuar se ekzistojnë të gjitha elementet e kësaj veprë penale dhe se ajo është konsumuar nga kërkuesi. Për sa i përket llojit dhe masës së dënimit, në referim të nenit 47 të KP-së, ajo gjykatë ka mbajtur në vëmendje rrezikshmërinë e veprës penale, për të cilën ligjvënësi ka parashikuar dënimin me burgim nga 5 deri në 10 vjet, faktin që kjo vepër është mjaft e përhapur, sasinë e lëndës narkotike të gjetur, e cila ka qenë e ulët, rrezikshmërinë e të pandehurit, e cila nuk paraqitej e lartë, faktin se kërkuesi nuk ka qenë i dënuar më parë, si dhe moshën e nivelin e tij arsimor. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur ankim në gjykatën e apelit.

4. Me vendimin nr. 597, datë 20.9.2017, Gjykata e Apelit Vlorë ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 472, datë 13.6.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe deklarin të pafajshëm të kërkuesit, me arsyetimin se provat e marra në shqyrtim nga gjykata e shkallës së parë nuk janë analizuar në lidhje me objektin e të provuarit të secilës prej tyre, duke mos përcaktuar vërtetësinë dhe fuqinë e tyre provuese. Sipas gjykatës së apelit, referuar neneve 152 dhe 383 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), gjykata e shkallës së parë nuk ka arsyetuar se mbi cilën prej këtyre provave ka krijuar bindjen se ka qenë i pandehuri ai që ka kryer veprën penale, ndërkohë që ka rezultuar e provuar se i pandehuri nuk ka qenë i pranishëm në lokal kur është kryer kontrolli dhe, për më tepër, vendimi i dënimit të të pandehurit është mbështetur vetëm mbi deklarinimet e një personi, i cili ka qenë nën hetim. Në vendin ku është gjetur lënda narkotike, kanë qenë persona të tjerë, njëri prej të cilëve duke përdorur lëndë narkotike. Gjykata e apelit ka çmuar se, bazuar në nenin 4 të KPP-së, akuza dhe fajësia në ngarkim të kërkuesit nuk provohen tej çdo dyshimi të arsyeshëm, pasi ndonëse lënda narkotike është gjetur në lokalin e marrë me qira prej tij, vendi ku është gjetur konkretisht ajo provohet të ketë qenë në përdorim edhe nga klientët e atij lokali. Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë ka paraqitur rekurs Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Vlorë.

5. Me vendimin nr. 00-2023- 731 (136), datë 25.4.2023, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, duke vlerësuar se gjykata e apelit, në zbatim të gabuar të nenit 432 pika 1, shkronja “b”, të KPP-së, nuk ka vlerësuar drejt veprimet e të pandehurit, të atribuara nga akuza, si veprime që përbëjnë elementet e figurës së veprës penale, anës objektive dhe subjektive të veprës penale, si dhe nuk ka interpretuar drejt nenin 4, pika 2 dhe nenin 152 të KPP-së. Kolegji Penal ka vlerësuar të gabuar edhe interpretimin e gjykatës së apelit për sa i përket vendit ku është gjetur kjo sasi lënde narkotike, duke vlerësuar se arsyetimi në lidhje me të nuk është në përputhje me ligjin material penal, pasi, në interpretim të nenit 283 të KP-së, qëllimi i ligjvënësit është garantimi i një mbrojtjeje të posaçme juridike për të siguruar rendin e sigurinë publike, jetën dhe shëndetin e njeriut, rregullat për shitjen, dhënien ose marrjen, mbajtjen në çdo mënyrë të substancave narkotike dhe psikotrope, përveç rastit të përdorimit vetjak dhe në doza të vogla.

6. Më datë 22.9.2023, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues sipas objektit të tij. Më datë 20.11.2023, Kolegji i Gjykatës, bazuar në nenin 21, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

7. *Kërkuesi* ka pretenduar cenimin e *së drejtës për proces të rregullt*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

7.1 *Së drejtës për t'u njoftuar*, pasi është detyrë e autoriteteve shtetërore përkatëse që të njoftojnë në mënyrë rigorozë, konform kërkesave procedurale, të pandehurin ndaj të cilit ka filluar dhe vazhdon një proces penal. Vetëm në këtë mënyrë mund të arrihet në përfundimin se i pandehuri ka hequr dorë vullnetarisht nga pjesëmarrja në gjykim. Vërtetimi i fakteve për njoftimin është detyrë e organeve kompetente. Po kështu, vendimi i Gjykatës së Lartë nuk i është njoftuar kërkuesit, i cili ka qenë në gjendje të lirë prej shumë kohësh, për shkak të vendimit të gjykatës së apelit që e kishte deklaruar të

pafajshëm. Kërkuesi është vënë në dijeni nga Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP), Tiranë për vendimmarrjen e Gjykatës së Lartë, më datën 17.8.2023.

7.2 *Së drejtës për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur*, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit, e cila e ka shpallur të pafajshëm, duke lënë në fuqi vendimin e gjykatës së rrethit, që e ka dënuar me 5 vjet burgim kërkuesin, shumë vite pas dhënies së vendimit të pafajësisë. Një vendim i tillë duhej të merrej nga Gjykata e Lartë në seancë gjyqësore në praninë e palëve, pasi asnjë dispozitë ligjore nuk parashikon një vendimmarrje të tillë nga ana e saj. Gjykimi i çështjes nga kjo gjykatë është bërë në mungesë të kërkuesit dhe mbrojtjes së tij, duke i cenuar në këtë mënyrë të drejtën për t'u dëgjuar e për t'u mbrojtur.

7.3 *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, ka vendosur prishjen e vendimit të pafajësisë së kërkuesit, ndërkohë që kjo çështje duhej të shqyrtohej në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Gjykata e Lartë nuk e ka ushtruar funksionin e saj të kontrollit të zbatimit të ligjit, por ka funksionuar si gjykatë fakti, duke bërë vlerësimin e provave.

7.4 *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi gjykata e rrethit e ka mbështetur fajësinë mbi një deklarami i cili nuk ka qenë i harmonizuar me prova të tjera dhe pa arsyetuar elementet e veprës penale. Gjykata e Lartë nuk e ka arsyetuar drejt prishjen e vendimit të gjykatës së apelit, nuk ka analizuar elementet e anës objektive dhe subjektive të veprës penale, për të cilën ai është akuzuar, nuk i ka kushtuar vëmendjen e duhur dhe nuk ka analizuar hollësisht provat, konkretisht faktin se ai nuk ka qenë prezent në vendin e ngjarjes, duke realizuar në këtë mënyrë një gjykim të cunguar dhe jo objektiv, në kundërshtim me nenin 383 të KPP-së.

8. ***Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme***, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

8.1 Për sa i përket pretendimit për cenimin e *së drejtës për t'u njoftuar*, rezulton se, sipas procesverbalit të datës 25.4.2023 të Gjykatës së Lartë për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi, palët kanë pasur dijeni rregullisht sipas ligjit, me anë të shpalljes publike të datës 24.3.2023 dhe nuk kanë paraqitur ndonjë kërkesë procedurale. Pavarësisht marrjes dijeni, kërkuesi nuk ka paraqitur asnjë pretendim rreth rekursit të prokurorisë. Ndryshimet ligjore që ka pësuar KPP-ja pas ushtrimit të rekursit nga prokuroria, konkretisht me ligjin nr. 41, datë 23.3.2021, "*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, "Kodi i Procedurës Penale"* (ligji nr. 41/2021), parashikojnë rregullimin e përbërjes së trupave gjykues, si dhe procedurën e gjykimit në Gjykatën e Lartë sipas përcaktimeve të këtij ligji, pavarësisht parashikimeve të ndryshme në ligje të tjera. Sipas dispozitave kalimtare, rekursi e paraqitura, por ende të pashqyrtuara, konsiderohen të pranueshme nëse plotësojnë parashikimet e ligjit në fuqi në kohën e depozitimit të tyre.

8.2 Për sa i përket pretendimit *për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj*, dispozitat e reja procedurale parashikojnë se shqyrtimi i rekursit në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, dhe shqyrtimi në seancë gjyqësore me praninë e palëve bëhet nëse vlerësohet e nevojshme nga Kolegji Penal thirrja dhe dëgjimi i tyre për shkak të problematikës ose kompleksitetit të çështjes. Në rastin e kërkuesit Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, pasi është njohur me relacionin e gjyqtarit relator, ka konstatuar se çështja mund të zgjidhej në dhomë këshillimi çka e bën vendimin plotësisht legjitim dhe të gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj, për shkak të gjykimit të çështjes së tij në dhomë këshillimi në Gjykatën e Lartë, është i pabazuar.

8.3 Në lidhje me cenimin e *së drejtës për t'u dëgjuar*, në ushtrimin e funksionit të saj si gjykatë e ligjit, Gjykata e Lartë mund të vendosë për themelin e çështjes vetëm nëse mosmarrëveshja mund të zgjidhet në bazë të të njëjtave fakte dhe prova të vlerësuara nga gjyqtari i faktit dhe që përbëjnë bazën e vendimit në të cilin është bërë një interpretim i gabuar i ligjit. Gjykata e Lartë ka vendosur ta zgjidhë çështjen në dhomë këshillimi, sipas parashikimit të pikës 1 të nenit 436/a të KPP-së, pasi ajo ishte plotësisht e qartë. Po kështu, rekursi i paraqitur nga prokuroria është marrë në shqyrtim nga Gjykata e Lartë, duke u dhënë përgjigje të argumentuar pretendimeve të ngritura në të, për të cilat, deri në momentin

e shqyrtimit të rekursit, kërkuesi nuk ka parashtruar asnjë lloj pretendimi, ndonëse është vënë në dijeni për datën e zhvillimit të seancës gjyqësore në dhomën e këshillimit.

8.4 Pretendimet e kërkuesit *për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, për sa i përket arsytimit të Gjykatës së Lartë në lidhje me fajësinë e tij, kanë të bëjnë me çmuarjen e provave nga gjykatat, çështje kjo që i përket juridiksionit të gjykatave të zakonshme.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

9. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik subjekt i së drejtës, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, si dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

10. Si bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

11. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës, Gjykata vëren se kërkuesi i është drejtuar asaj me ankim kushtetues individual, duke ngritur pretendime për procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, për të cilin nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç ankimit kushtetues individual.

12. Në lidhje me legjitimitimin *ratione temporis*, Gjykata evidenton se vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë mban datën 25.4.2023, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë më datë 22.9.2023. Nga dokumentacioni i dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të gjykimit kushtetues, Gjykata konstaton se vendimi nr. 00-2023-731(136), datë 25.4.2023 i Kolegjit Penal i është njoftuar përfaqësuesit të kërkuesit më datë 7.7.2023, nëpërmjet postës elektronike, për rrjedhojë kërkesa konsiderohet e paraqitur brenda afatit 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

13. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të së drejtës për t’u njoftuar, së drejtës për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur, cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor dhe së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj. Për sa i përket pretendimit për cenimin e *së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, kërkuesi ka pretenduar se Kolegji Penal në dhomë këshillimi, ka vendosur prishjen e vendimit të pafajësisë së kërkuesit, ndërkohë që kjo çështje duhej të shqyrtohej në seancë gjyqësore në praninë e palëve dhe se Gjykata e Lartë nuk e ka ushtruar funksionin e saj të kontrollit të zbatimit të ligjit, por ka funksionuar si gjykatë fakti, duke bërë vlerësimin e provave. Gjykata vlerëson se, për sa i përket pretendimit për shqyrtimin e çështjes nga Kolegji Penal në dhomë këshillimi, në referim të nenit 436/a, pika 1, të KPP-së, shqyrtimi i çështjes në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, është forma e gjykimit që ndiqet si rregull tashmë në Gjykatën e Lartë. Për pretendimin se Gjykata e Lartë nuk ka ushtruar funksionin e saj të kontrollit të zbatimit të ligjit, por ka funksionuar si gjykatë fakti, Gjykata vlerëson se kërkuesi nuk ka paraqitur asnjë fakt konkret mbi të cilën mbështet pretendimin e tij. Ndërsa për pretendimin se Kolegji Penal ka prishur vendimin e gjykatës së apelit, i cili e kishte deklaruar të pafajshëm kërkuesin, Gjykata vlerëson se kompetencën

për prishjen e vendimeve të gjykatave më të ulëta Gjykatës së Lartë ia njej KPP-ja, nëpërmjet nenit 441 të saj. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se pretendimi për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj nuk rezulton i argumentuar në këndvështrimin kushtetues dhe se kërkuesi nuk ka arritur të provojë cenimin e kësaj të drejtë.

14. Në lidhje me pretendimet për cenimin e *së drejtës për t'u njoftuar, për t'u dëgjuar dhe mbrojtur* si dhe *standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pavarësisht mënyrës si janë formuluar, Gjykata çmon të mos mbajë qasje formaliste, por në vështrim të funksionit të saj kushtetues t'i analizojë ato për bazueshmërinë e tyre në themel.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e së drejtës për t'u njoftuar të lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur

15. Kërkuesi ka pretenduar se është detyrë e autoriteteve shtetërore përkatëse që të njoftojnë në mënyrë rigorozë, konform kërkesave procedurale, të pandehurin ndaj të cilit ka filluar dhe vazhdon një proces penal, pasi vetëm në këtë mënyrë mund të arrihet në përfundimin se i pandehuri ka hequr dorë vullnetarisht nga pjesëmarrja në gjykim. Sipas tij, vërtetimi i këtyre fakteve është detyrë e organeve kompetente. Ai ka pretenduar gjithashtu se vendimi i Gjykatës së Lartë nuk i është njoftuar, edhe pse ka qenë në gjendje të lirë prej shumë kohësh, për shkak të vendimit të gjykatës së apelit që e kishte deklaruar të pafajshëm dhe se është vënë në dijeni nga IEVP-ja, Tiranë për vendimmarrjen e Gjykatës së Lartë, më datë 17.8.2023.

16. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar se kërkuesi është njoftuar rregullisht, sipas ligjit, me anë të shpalljes publike të datës 24.3.2023, për datën dhe orën e shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Lartë dhe nuk ka paraqitur ndonjë kërkesë procedurale. Po sipas këtij subjekti, ndryshimet ligjore që ka pësuar KPP-ja me ligjin nr. 41/2021, pas ushtrimit të rekursit nga ana e tij, kanë parashikuar shqyrtimin e çështjes nga Gjykata e Lartë në dhomë këshillimi. Gjithashtu, sipas neni 435/a të KPP-së, të shtuar me këtë ligj, pala kundër së cilës është paraqitur rekurs mund ta kundërshtojë atë me kundërrekurs brenda 20 ditëve nga dita kur ka marrë njoftimin për rekursin e palës tjetër, ndërkohë që rezulton se kërkuesi nuk e ka ushtruar këtë të drejtë. Rekursi i paraqitur prej saj është marrë në shqyrtim nga Gjykata e Lartë, duke iu dhënë përgjigje të argumentuar pretendimeve të ngritura në të dhe deri në momentin e shqyrtimit të tij, kërkuesi nuk ka parashtruar asnjë lloj pretendimi, ndonëse është vënë në dijeni të seancës.

17. Gjykata në jurisprudencën e saj ka përcaktuar disa standarde kushtetuese, të cilat janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën në mënyrë të tillë që cenimi i njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerëve. Konkretisht, e drejta për t'u njoftuar për një seancë gjykimi dhe pjesëmarrja në të është e lidhur me vendimmarrjen e gjykatës, e cila ndikon drejtpërsëdrejti mbi të drejtat subjektive ose interesat e ligjshëm të individit. E drejta për t'u njoftuar për të marrë pjesë në gjykim u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor. Nga ana tjetër, e drejta për të marrë pjesë në gjykim krijon të njëjtat mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjakë në raport me palën kundërshtare (*shih vendimet nr. 8, datë 23.2.2021; nr. 49, datë 22.7.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Për sa i takon procesit në Gjykatën e Lartë, kjo e fundit, pavarësisht nëse i shqyrton çështjet në seancë të hapur publike ose mbi bazë të dokumenteve, duhet t'u garantojë palëve të drejtën që jo vetëm të njihen në kohë me pretendimet e palës tjetër, por edhe të kenë mundësinë që t'i kundërshtojnë ato ose të paraqesin argumentet e tyre për çështjen. Ajo ka detyrimin të verifikojë nëse palët në proces kanë marrë dijeni efektivisht për procesin, me qëllim garantimin e së drejtës së mbrojtjes dhe barazisë së armëve në gjykim (*shih vendimet nr. 41, datë 18.9.2023; nr. 13, datë 12.3.2023; 17, datë 1.3.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Gjykata ka theksuar se parametrat kushtetues që garantojnë të drejtën për proces të rregullt ligjor, në radhë të parë, duhet të parashikohen nga legjislacioni procedural dhe, më pas, sipas rastit, duhet të përmbushen nga organet e pushtetit publik, përfshirë gjykatat nëpërmjet zbatimit të

dispozitave ligjore procedurale. Në këtë këndvështrim, kur ankimi kushtetues individual ka në objektin e tij mënyrën se si kanë vepruar këto organe, atëherë kontrolli kushtetues ushtrohet për të verifikuar nëse organi i pushtetit publik ka përmbushur detyrimet ligjore në atë masë që të jetë respektuar e drejta kushtetuese për proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 48, datë 11.10.2023; nr. 35, datë 15.6.2023; nr. 38, datë 2.12.2021*).

20. Duke iu rikthyer rrethanave të çështjes në shqyrtim, Gjykata vëren se referuar akteve të dosjes gjyqësore, kërkuesi është gjykuar në gjendje të lirë. Si gjatë hetimeve paraprake, ashtu edhe gjatë gjykimit ai është përfaqësuar nga avokati Z.H., të cilit i ka dhënë edhe tagra për përfaqësimin në Gjykatën.

21. Po kështu, Gjykata konstaton se njoftimet e kërkuesit për procesin gjyqësor, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier i ka kryer në adresën lagja “Liri”, përballë “Shtëpisë së të Moshuarve, Fier”, ndërsa fletëthirrjet për seancat gjyqësore të datave 23.9.2014, 7.10.2014 dhe 22.10.2014 mbajnë shënimin “*nga verifikimi që u bë në këtë adresë personi nuk njihet*”. Në kushtet kur kërkuesi nuk është paraqitur, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendim të ndërmjetëm, ka vendosur që njoftimi i tij të bëhet nëpërmjet shërbimeve të Policisë Gjyqësore pranë Komisarariatit të Policisë Fier dhe u ka kërkuar këtyre të fundit, njoftimin e të pandehurit (*kërkuesit*) për seancën gjyqësore të datës 6.11.2014. Me shkresën e datës 5.11.2014, Komisarati i Policisë Fier ka bërë me dije gjykatën se kërkuesi ka marrë dijeni për seancën, duke i bashkëlidhur edhe fletëthirrjen e nënshkruar prej tij. Sipas procesverbalit të seancës gjyqësore të datës 6.11.2014, rezulton se kërkuesi dhe mbrojtësi i tij Z.H. kanë qenë të pranishëm. Në vijim, kërkuesi ka marrë pjesë në katër seanca gjyqësore, ndërsa në dy seancat e fundit, atë të datës 28.4.2015 dhe 13.6.2016, kërkuesi nuk është paraqitur dhe gjykimi ka vijuar në prani të mbrojtësit Z.H., ku gjykata e rrethit ka shpallur edhe vendimin. Ky vendim rezulton t’i jetë komunikuar shtetasit K.M. (*babait të kërkuesit*), më datë 27.6.2016, sipas dëftesës së komunikimit të administruar në dosjen gjyqësore.

22. Për shqyrtimin e çështjes në Gjykatën e Apelit Vlorë, njoftimi për kërkuesin është bërë me shpalljen e datës 28.7.2017, pasi nga fletëthirrja ka rezultuar adresë e pasaktë. Gjatë këtij gjykimi kërkuesi nuk rezulton të jetë paraqitur, por është përfaqësuar sërish nga mbrojtësi Z.H. Vendimi nr. 597, datë 20.9.2017 i Gjykatës së Apelit Vlorë, sipas dëftesës së komunikimit të datës 6.10.2017, rezulton se i është njoftuar avokatit Z.H. nëpërmjet telefonit.

23. Për sa i përket njoftimit të rekursit, Gjykata evidenton se më datë 1.11.2017, rekursi i është komunikuar babait të kërkuesit nëpërmjet dëftesës së komunikimit në adresën e banimit, lagja “Liri”, Fier dhe sipas shënimit në këtë dëftesë komunikimi, ai ka “*refuzuar të firmosë*”. Gjithashtu, Gjykata vëren se njoftimi i rekursit nuk i është njoftuar personalisht kërkuesit dhe as mbrojtësit të tij në adresën elektronike të lënë nga ky i fundit ose në një nga format e tjera të parashikuara nga neni 140, pika 5, i KPP-së, i cili parashikon se kur personat e treguar në paragrafin 1 të këtij neni (*personi që bashkëjeton, fqinji ose personi që punon me të*) nuk janë të përshtatshëm ose refuzojnë të marrin aktin, atëherë procedohet me kërkimin e të pandehurit në vende të tjera. Në rast se edhe në këtë mënyrë nuk mund të bëhet njoftimi, akti depozitohet në qendrën administrative të lagjes ose të fshatit ku i pandehuri banon ose punon. Lajmërimi i depozitimit afishohet në portën e shtëpisë së të pandehurit ose të vendit ku punon, këndin e afishimit dhe në faqen e internetit të gjykatës. Ftuesi gjyqësor e lajmëron atë për depozitim me letër rekomande me lajmërim marrje. Efektet e njoftimit rrjedhin që nga marrja e rekomandesë.

24. Për sa i përket njoftimit për datën dhe orën e shqyrtimit të rekursit në Gjykatën e Lartë, Gjykata vëren se nga aktet e dosjes gjyqësore avokati Z.H. ka deklaruar për efekt njoftimi adresën elektronike si në parashtrimet në gjykatën e rrethit, po kështu edhe në ankimin e paraqitur në gjykatën e apelit. Megjithatë, nga aktet e dosjes gjyqësore dhe ato bashkëlidhur kërkesës nuk rezulton që Gjykata e Lartë ta ketë njoftuar atë përmes postës elektronike për orën dhe datën e shqyrtimit të çështjes. Për më tepër, Gjykata vëren se, krahas mangësive në njoftimin e rekursit, në kohën e paraqitjes së tij nga prokuroria (viti 2017), dispozitat procedurale në fuqi nuk parashikonin të drejtën e kundërrekursit nga pala kundër së cilës ishte ushtruar rekurs. Ndërsa me ndryshimet e bëra në KPP me ligjin nr. 41/2021, i cili ka hyrë

në fuqi më datë 29.5.2021 (para shpalljes së datës së seancës nga Gjykata e Lartë), është shtuar edhe neni 435/a “Kundërrekursi”, i cili parashikon se pala kundër së cilës është paraqitur rekurs mund ta kundërshtojë atë me kundërrekurs brenda 20 ditëve nga dita kur ka marrë njoftimin për rekursin e palës tjetër.

25. Gjykata konstaton se çështja është regjistruar në Gjykatën e Lartë me nr. 56250-01705-00-2017, datë 16.12.2017. Me urdhrin e datës 24.3.2022, relatori i çështjes ka vendosur shqyrtimin e saj në dhomë këshillimi, më datë 25.4.2023, dhe ka urdhëruar sekretarinë të kryejë shpalljen e njoftimit dhe njoftimin e palëve për orën dhe datën e gjykimit. Referuar akteve të dosjes gjyqësore të administruar, si dhe të dhënave të faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë, rezulton që më datë 24.3.2023 është publikuar në faqen e internetit, në rubrikën “*Për shqyrtim në dhomë këshillimi?*”, si dhe është shpallur në ambientet e asaj gjykate njoftimi për seancën gjyqësore të datës 25.4.2023. Më datë 25.4.2023, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka marrë në shqyrtim çështjen në dhomë këshillimit, duke vendosur, në përfundim, prishjen e vendimit të gjykatës së apelit, që e kishte deklaruar kërkuesi të pafajshëm dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit, nëpërmjet të cilit ai ishte dënuar me 5 vjet burgim.

26. Ky vendim i Gjykatës së Lartë rezulton në vijim t’i jetë njoftuar mbrojtësit të kërkuesit në adresën elektronike të deklaruar prej tij.

27. Në referim të ndryshimeve të bëra KPP-së me ligjin nr. 41/2021, në nenin 436 të tij janë përcaktuar rregullat e shqyrtimit të çështjeve në dhomë këshillimi, si dhe mënyra e njoftimit të palëve. Sipas pikës 3 të këtij neni, për shqyrtimin e çështjes sekretaria e gjykatës njofton palët nëpërmjet afishimit në këndin e njoftimeve dhe faqen elektronike zyrtare për datën dhe orën e gjykimit të paktën 30 ditë përpara. Krahas njoftimit me shpallje, kjo dispozitë parashikon edhe njoftimin individual kur palët ose përfaqësuesit e tyre kanë lënë të dhënat e tyre elektronike të kontaktit në shkallët e tjera të gjykimit. Këto rregulla janë detajuar edhe në urdhrin nr. 131, datë 2.7.2021, “Për publikimin e datave të gjykrimeve dhe njoftimin e palëve” të nxjerrë nga zëvendëskryetari i Gjykatës së Lartë. Ndërsa, sipas nenit 436/a, pika 1, të KPP-së, të ndryshuar, shqyrtimi i rekursit në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomë këshillimi.

28. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se mungesa e njoftimit të mbrojtësit të kërkuesit për seancën në Gjykatën e Lartë, në kushtet kur ai nuk kishte mundësi për të paraqitur më parë pretendime në lidhje me rekursin e prokurorit, për shkak të parregullsive në njoftimin e tij (*shih paragrafin 23 të vendimit*) dhe, për më tepër, kur objekt i rekursit është vendimi që e kishte deklaruar të pafajshëm kërkuesin, vë në dyshim respektimin e së drejtës për t’u dëgjuar dhe mbrojtur në aspektin substancial të saj. Edhe pse Gjykata e Lartë ka respektuar formalisht dispozitat procedurale që parashikojnë njoftimin në faqen e internetit dhe ambientet fizike të saj, në aspektin substancial kërkuesi, në referim edhe të ndryshimeve ligjore, ka qenë në pamundësi të ushtrojë të drejtën e mbrojtjes ndaj shkaqeve të rekursit dhe të parashtrijë pretendimet e tij në lidhje me procesin gjyqësor të kundërshtuar, në kuptim edhe të parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit. Për më tepër, mbi bazën e shkaqeve të rekursit të prokurorisë, Kolegji Penal ka prishur vendimin e gjykatës së apelit, i cili e kishte deklaruar kërkuesin të pafajshëm, duke lënë në fuqi vendimin e gjykatës së rrethit, i cili e kishte dënuar atë me 5 vjet, pas një kohe prej më shumë se 5 vjetësh nga dhënia e vendimit të gjykatës së apelit. Gjykata e Lartë nuk rezulton të ketë analizuar parashikimet e reja ligjore në funksion të mundësisë së kundërshtimit nga kërkuesi të pretendimeve të prokurorisë, në ushtrim të së drejtës së tij për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur. Gjykata ripohon rolin e Gjykatës së Lartë, e cila si gjykatë e ligjit i ka të gjitha mjetet dhe kompetencat për të ushtruar rol aktiv, që shkon përtej ligjit dhe synon të drejtën, duke ndikuar efektivisht edhe në vendimmarrjen e gjykatave të shkallëve më të ulëta (*shih vendimet nr. 42, datë 7.7.2014; nr. 4, datë 5.2.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Për sa më sipër, Gjykata çmon se mungesa e njoftimit nga Gjykata e Lartë për orën dhe datën e shqyrtimit të çështjes së kërkuesit në adresën elektronike të deklaruar të përfaqësuesit tij, sipas përcaktimeve të nenit 436, pika 3, të KPP-së, përbën cenim të së drejtës për t’u njoftuar të lidhur me të drejtën për t’u dëgjuar dhe mbrojtur. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se shkeljet e konstatuara kanë

pasur ndikim të drejtpërdrejtë në procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë, duke e bërë atë proces të parregullt në kuptimin kushtetues, ndaj pretendimi i kërkesit është i bazuar.

30. Për sa i takon pretendimit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit të Gjykatës së Lartë, Gjykata vlerëson të mos ndalet në analizimin e tij, përderisa çështja do të merret përsëri në shqyrtim nga Gjykata e Lartë, e cila në funksion të rolit të saj si gjykatë e ligjit duhet t'i japë përgjigje të arsyetuar këtij pretendimi.

31. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimi i kërkesit për cenimin e së drejtës për t'u njoftuar të lidhur edhe me të drejtën për t'u dëgjuar dhe mbrojtur është i bazuar, sipas arsyetimit të mësipërm, ndaj kërkesa pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "P" dhe 134, pika 1, shkronja "I", të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2023-731(136), datë 25.4.2023, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.
Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë, më 23.4.2024.

Shpallur, më 20.5.2024.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja, Genti Ibrahim

Anëtarë kundër: Ilir Toska, Sandër Beci, Elsa Toska, Marjana Semini

MENDIM PAKICE

1. Në shqyrtimin e çështjes me kërkesë Rezart Myslymi, me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 00-2023-731(136), datë 25.4.2023, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, ne gjyqtarët në pakicë kemi votuar për rrëzimin e kërkesës. Duke qenë se nuk ndajmë të njëjtin qëndrim me shumicën, në lidhje me përfundimin e arritur për shfuqizimin e vendimit gjyqësor të kundërshtuar dhe argumentet mbi të cilat mbështetet ky qëndrim, vlerësojmë të shprehemi me mendim pakice.

2. Nga rrethanat e çështjes rezulton se kërkesi është dënuar në vitin 2016 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier me 5 vjet burgim për veprën penale të prodhimit dhe shitjes të lëndëve narkotike. Mbi bazën e ankimit të tij, në vitin 2017 Gjykata e Apelit Vlorë e ka ndryshuar vendimin e gjykatës së rrethit, duke e shpallur kërkesin të pafajshëm. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs prokuroria dhe, në vijim, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin e datës 25.4.2023, ka prishur vendimin e gjykatës së apelit, duke lënë në fuqi vendimin e gjykatës së rrethit.

3. Kërkesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, të së drejtës për t'u dëgjuar dhe standardit të arsyetimit. Shumica ka vlerësuar të pabazuar pretendimin e kërkesit për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, përfundim për të cilin edhe ne gjyqtarët në pakicë ndajmë të njëjtin qëndrim. Ndërkohë, në lidhje me dy pretendimet e tjera, shumica ka vlerësuar t'i trajtojë ato në drejtim

të së drejtës për t'u njoftuar të lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, pavarësisht mënyrës së formulimit të tyre nga kërkuesi, duke e arsyetuar këtë në vështrim të funksionit të kushtetues të Gjykatës dhe larguar qasjes formaliste (*shih paragrafin 14 të vendimit*). Më tej, shumica ka arritur në përfundimin se kërkuesit i është cenuar e drejta për t'u njoftuar e lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar dhe mbrojtur, për të cilin ne gjyqtarët në pakicë ndajmë qëndrim të kundërt për arsyet e mëposhtme.

4. Së pari, në aspektin formal, kërkuesi ka pretenduar vetëm cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar. Në lidhje me këtë pretendim, kërkuesi nuk ka parashtruar ndonjë fakt ose argument konkret. Ai thjesht ka bërë disa citime nga jurisprudenca e Gjykatës në lidhje me rëndësinë e së drejtës së palëve për të qenë të pranishme dhe për t'u mbrojtur në një proces gjyqësor, si dhe sa i përket gjykimit në mungesë (*vendimet nr. 8, datë 27.2.2014; nr. 30, datë 17.6.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Po ashtu, ai ka bërë citime nga jurisprudenca e Gjykatës edhe në lidhje me rëndësinë e njoftimit të të pandehurit të lidhur me të drejtën për të qenë i pranishëm në një proces penal (*vendimet nr. 39, datë 26.7.2013; nr. 26, datë 8.5.2012; nr. 45, datë 10.10.2011; nr. 30, datë 17.6.2010*).

5. Në vlerësimin tonë, ngritja në këtë mënyrë e këtij pretendimi nga kërkuesi, pa parashtruar fakte dhe argumente konkrete në drejtim të cenimit të asaj të drejte, nuk mund të çojë në përfundimin për qenien e tij i bazuar. Edhe pse Gjykata, bazuar mbi parimin *iura novit curia*, ("*Gjykata e njeh Kushtetutën*"), në thelb e analizon një pretendim të kërkuesit sipas standardeve dhe parimeve kushtetuese që ajo vlerëson se lidhen me të, pavarësisht se si e ka kërkuar kërkuesi, gjithsesi ky parim nënkupton një përshkrim të qartë të pretendimit, në mënyrë që gjykata ta analizojë atë nën dritën e standardeve kushtetuese.

6. Së dyti, duke mos i qëndruar kërkesës në kuptimin e identifikimit të argumenteve për cenimin konkret të pretenduar sipas strukturimit të kërkesës nga kërkuesi, por duke e vlerësuar atë në tërësi, mendojmë se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar duket se lidhet me argumentin e tij se Gjykata e Lartë nuk duhej ta kishte gjykuar çështjen në dhomë këshillimi, por në seancë gjyqësore me praninë e palëve, argument ky i parashtruar nga kërkuesi në funksion të pretendimit për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj. Nisur nga kjo, për sa kohë ky i fundit u gjet i pabazuar, edhe pretendimi për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar, i mbështetur mbi të njëjtin argument, duhet të vlerësohej i pabazuar.

7. Së treti, edhe në këndvështrim të fakteve të evidentuara nga shumica, ndajmë vlerësim të ndryshëm nga përfundimi i arritur prej saj. Konkretisht, shumica e ka vlerësuar të bazuar pretendimin e kërkuesit për cenimin e së drejtës për t'u njoftuar, duke e mbështetur qëndrimin e saj në faktin se rekursi i prokurorit është komunikuar në adresën e vendbanimit të deklaruar, por babai i kërkuesit ka refuzuar marrjen e njoftimit, ndërkohë që nuk janë bërë përpjekje për njoftimin e të pandehurit (kërkuesit) sipas përcaktimeve të nenit 140, pika 5, të KPP-së, sikundër edhe për njoftimin e mbrojtësit të tij. Po ashtu, qëndrimin e saj shumica e ka mbështetur edhe në faktin se njoftimi për datën dhe orën e shqyrtimit të rekursit duhej të bëhej, përveçse përmes shpalljes në ambientet e Gjykatës së Lartë dhe faqes zyrtare të saj, edhe në adresën elektronike të mbrojtësit të kërkuesit. Nisur edhe nga fakti se çështja është shqyrtuar në dhomë këshillimi nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i cili ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së rrethit pas më shumë se 5 vjetësh që kërkuesi ishte shpallur i pafajshëm nga gjykata e apelit, shumica ka vlerësuar se mosnjoftimi i kërkuesit për datën dhe orën e shqyrtimit të çështjes së tij përbën shkelje me natyrë substanciale, e cila, për rrjedhojë, ka sjellë edhe cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar dhe mbrojtur (*shih paragrafët 23, 27, 28 dhe 29 të vendimit*).

8. Për sa më lart, ndahemi nga qëndrimi i shumicës, pasi sikundër theksuam, kërkuesi nuk ka parashtruar ndonjë kundërshtim për mosnjoftimin atij të rekursit të prokurorit apo për mosnjoftimin e mbrojtësit të tij, në adresën elektronike, për seancën gjyqësore në Gjykatën e Lartë në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh. Në këtë kuptim, për sa kohë vetë kërkuesi nuk ka parashtruar kundërshtime për këto aspekte të procesit gjyqësor, ato nuk mund të pranohen si të tilla dhe t'i atashohen pretendimit të tij për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar dhe, në vijim, për të konkluduar në lidhje me bazueshmërinë e tij.

9. Po ashtu, ndahemi me këtë qasje formaliste të shumicës, pasi vlerësojmë se nga pikëpamja e standardeve kushtetuese, e drejta për t'u njoftuar është e lidhur ngushtësisht me të drejta të tjera të natyrës procedurale, si e drejta për t'u dëgjuar, parimi i kontradiktoritetit dhe mbrojtjes efektive. Nëse nuk arrihet të provohet shkelje e ndonjëres prej këtyre të drejtave, mosnjoftimi në vetvete nuk e bën procesin të parregullt, pasi nuk ka sjellë pasoja antikushtetuese. Shumica edhe pse e ka parë në vështirimin e së drejtës për t'u dëgjuar, nuk ka arritur të analizojë se si i është mohuar kërkuesit substancialisht kjo e drejtë në rastin konkret.

10. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se jo çdo shkelje e bën procesin të parregullt, në aspektin e cenimit të të drejtave kushtetuese, dhe se ndikim të drejtpërdrejtë në një proces ligjor kanë ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të individit (*shih vendimet nr. 5, datë 9.2.2023; nr. 38, datë 2.12.2021; nr. 71, datë 13.11.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjatë shqyrtimit të pretendimeve për të drejtën për proces të rregullt nuk mjafton vetëm konstatimi i shkeljes procedurale, por duhet të analizohet karakteri i saj, pasojat që kanë ardhur për kërkuesin dhe për interesat që ai përfaqëson (*shih vendimet nr. 5, datë 9.2.2023; nr. 38, datë 2.12.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Në çdo çështje të veçantë, duke pasur parasysh edhe të gjithë procedurën që mund të jetë ndjekur, Gjykata vlerëson nëse një kufizim ose shkelje gjatë kësaj procedure ka ndikuar drejtpërdrejt në zgjidhjen e çështjes dhe ia ka bërë palës të pamundur mbrojtjen dhe zhvillimin e procesit gjyqësor në mënyrë të drejtë (*shih vendimet nr. 5, datë 9.2.2023; nr. 7, datë 28.2.2000 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në vështirim të standardeve kushtetuese, vlerësojmë se mangësitë në njoftimin me *e-mail* të shqyrtimit të seancës gjyqësore në dhomë këshillimi nuk mund të konsiderohen si shkelje substanciale, që e bëjnë të parregullt, në kuptimin kushtetues, procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, për sa kohë që kërkuesi nuk ka arritur të argumentojë se si rrjedhojë e mosnjoftimit në këtë formë për datën e gjykimit në Gjykatën e Lartë atij i janë cenuar edhe të drejta të tjera të lidhura me kontradiktoritetin, dhe mbrojtjen efektive, apo se ky mosnjoftim i ka sjellë pasoja antikushtetuese në raport me procesin penal në ngarkim të tij.

12. Konkretisht, për sa i përket njoftimit të kërkuesit për datën dhe orën e shqyrtimit të çështjes, është e rëndësishme të theksohet se edhe pse nuk është njoftuar në adresën elektronike të avokatit të kërkuesit, në rastin në shqyrtim, ky njoftim është kryer sipas mënyrës kryesore që neni 463, pika 3, i KPP-së përcakton, pra nëpërmjet afishimit të tij në këndin e njoftimeve dhe në faqen elektronike zyrtare të Gjykatës së Lartë. Gjithashtu, siç nuk kontestohet edhe nga shumica, pavarësisht se sipas saj vërehen mangësi në njoftim, kërkuesi ka qenë në dijeni se nga prokuroria është paraqitur rekurs, i cili i është njoftuar të atit të kërkuesit në adresën e deklaruar prej tij, gjatë gjykimit në gjykatat e faktit, për rrjedhojë ai ka pasur dijeni se procesi ndaj tij vazhdon. Po ashtu, ai ka qenë i mbrojtur me përfaqësues ligjor, i cili ka pasur detyrimin për ndjekjen e njoftimeve edhe në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë për çështjen gjyqësore në ngarkim të të përfaqësuarit prej tij. Për më tepër, në ankimin individual drejtuar Gjykatës ai nuk ka paraqitur argumente konkret se në rast se do të njoftohej për datën dhe orën e shqyrtimit të çështjes edhe përmes e-mailit, çfarë veprimi konkretisht do të ndërmernte në lidhje këtë proces dhe nëse do të paraqiste argumente të reja dhe të lidhura me perspektivën e procesit të themelit në aspektin ligjor. Vlen të theksohet se pretendimet e mbrojtjes në lidhje me pafajësinë e kërkuesit janë marrë në konsideratë nga gjykata e apelit, e cila i ka bërë ato pjesë të vendimit të saj, ndërkohë që është pikërisht ky vendimi që i është nënshtruar kontrollit rishikues të Gjykatës së Lartë. Në këtë kuptim, ndryshe nga shumica, vlerësojmë se parregullsitë në njoftimin e gjykimit të çështjes në Gjykatën e Lartë nuk janë të atilla që mund të çojnë në përfundimin e mungesës së njoftimit, çka do ta bënte procesin të parregullt në tërësinë e tij, pasi njoftimi si element procedural nuk është qëllim në vetvete, por është në funksion të së drejtës për t'u dëgjuar dhe mbrojtur.

13. Në përfundim, në kuptim të normave kushtetuese, standardeve jurisprudenciale të kësaj Gjykate dhe analizës së natyrës kushtetuese të çështjes konkrete, vlerësojmë se pretendimi për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës për t'u njoftuar të lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur nuk është i bazuar, ndaj vlerësojmë se kërkesa duhej të rrëzohej, sipas arsytimit të mësipërm.

Anëtarë: Elsa Toska, Sandër Beci, Ilir Toska, Marjana Semini